a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nëshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkëlqje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁵Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik "....." për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik "....." të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁵ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Loti i Parë "Mirëmbajtje teknike të aparaturave live skanera të tipeve DS-40, DS-45, DPP-6P".

SPECIFIKIME TEKNIKE PER MIREMBAJTJEN TEKNIKE TE PAISJET E LIVE SKANERAVE TIP DS-40.

Kontraktuesi ka per detyre :

1. Te mbeshtese kapacitetin e paisjeve dhe softwareve te 4 cope live skanera te tipit DS-40 instaluar ne DVKM Shkoder, Tirane, Gjirokaster dhe Korce.

2. Te ekzekutoje keshillimet e operatoreve te Live Skanerave (me anen e telefonit, fakseve, sherbimit postar, postes elektronike etj) duke perfshire materiale informacioni falas.

3. Te dergoje ndryshimet dhe plotesime ne instalimin e softwarit me anen e postes elektronike ose me CD-R pa pagesa shtese.

4. Te rivere ne gjendjen e meparshme brenda 10 diteve kalenderike te aftesive te paisjeve ne rast difektesh.

Me aftesi te paisjeve do te kuptohet aftesia e tyre per te ekzekutuar :

- futjen e informacionit te database,
- realizimin e kerkimeve ne database,
- rifreskimin e listes se kandidateve,
- arshivimin e database
- pergatitjen e karteles daktiloskopike dhe dergimin e saj on-line ne databasen e sistemit AFIS/APIS Papillon 9 instaluar ne Sektorin e Daktiloskopise te Institutit te Policise Shkencore.

Ne keto terma nuk perfshihen:

- vazhdimi i udhetimit te ekspertit te shitesit ne vendin e operatorit te sistemit (ne rast nevoje ne pune e vendit te operatorit)
- vazhdimi i dergimit te paisjeve deri tek vendi i relaizimit te riparimit dhe kthimit.
- Per te riparuar hardwaret e treguara ne specifikimet ne aneksin 1 ne rast kur difektet e paisjeve jane shkaktuar si rezultat i difekteve te hardwareve te specifikimeve 1.1.

5. Te zevendesoje brenda 1 muaji pjese nga paisjet dhe softwaret e artikujve te aneksit 1 te specifikuara kur ato kane difekte, neqoftese aftesite e paisjeve nuk kane pesuar demtime mekanike.

Keto terma nuk perfshijne:

- kohen e dergimit te paisjeve deri ne vendin e riparimit e kthim.
- Ne kete kohe nuk perfshihen koha e riparimit te hardwareve te artikujve te aneksit 1 ne ras se sistemi ka pengesa te shkaktuar nga keto hardware.

Paisjet qe do te zevendesohen duhet te kene te njejtat karakteristika teknike ose edhe me te mira.

6. Te siguroje dergimin e paisjeve nga qyteti i Tiranës tek bleresi kur ato zevendesohen ose riparohen me shpenzimet e shitesit. Trasporti do te realizohet me ate tokesor.

7. Te ekzekutoje mbeshtetjen e paisjeve nepermjet linjes se hapur telefonike ne te gjitha ditet e punes nga ora 08 00 deri ora 16 30.

Perdoruesi ka per detyre:

1. te perdore paisjet sipas instruksioneve shpjeguese te guides te perdorimit te Live Skanerave tip DS-40.
2. te perdori sistemin e arshivimit ne database sipas te gjitha instruksioneve ne manualin e perdoruesit te Live Skanerave.
3. te perdori paisjet nga eksperte qe kane certifikaten e shitesit qe konfirmon kualifikimin e pershtatshem.

Specifikimet 1.1

Paisjet Live Skanera per kontrollin e gjurmeve te gishtave te tipit DS-40 (4 cope).

1. Paisje Live skaner per marrjen e gjurmeve te duarve te tipit e DS-40 cope 4.
2. Komjuter Pentium 4 IBM Intellistation E PRO CPU Pentium 4 2,2 Ghz, 256 RAM, HDD 40 GB cope 4.
3. Monitor 17 “ IBM T 39U3EU FD Trinitron 0,24, TCO-95 cope 4.
4. UPS 150VA cope 4.
5. Printer Lazer Jet 1200 cope 4.
6. Softwerin e paisjes per kontrollin on-lime me gjurme gishtash ne sistemit Afs, cope 4.
7. Softwerin per pergatitjen e kartelesa daktiloskopike dhe dergimin e saj ne sistemin Afs, cope 4.
8. Aparat fotografik Canon 1200, cope 4.

SPECIFIKIME TEKNIKE PER MIREMBAJTJEN TEKNIKE TE PAISJET E LIVE SKANERAVE TIP DS-45.

Kontraktuesi ka per detyre :

1. Te mbeshtese kapacitetin e paisjeve dhe softwareve te 26 cope Live Skanerave te tipit DS-45 te instaluar nga 1 cope ne DVPolicive Tirane, Shkoder, Kukes, Lezhe, Diber, Durres, Elbasan, Korce, Fier, Vlore, Berat, Gjirokaster, Kom.Pol.Nr.1,2,3,4,5,6 Tirane, Kom.Pol. Lac, Lushnje, Pogradec, Kavaje dhe Sarande si dhe 2 cope ne Komisiatin e Kufirit Rinas dhe 1 cope ne Komisariatit e Kufirit Porti Durresit.
2. Te ekzekutoje keshillimet e operatoreve te Live Skanerave (me anen e telefonit, fakseve, sherbimit postar, postes elektronike etj) duke perfshire materiale informacioni falas.
3. Te dergoje ndryshimet dhe plotesime ne instalimin e softwarit me anen e postes elektronike ose me CD-R pa pagesa shtese.
4. Te rivere ne gjendjen e meparshme brenda 10 diteve kalenderike te aftesive te paisjeve ne rast difektsh.

Me aftesi te paisjeve do te kuptohet aftesia e tyre per te ekzekutuar :

- futjen e informacionit te database,
- realizimin e kerkimeve ne database,
- rifreskimin e listes se kandidateve,
- arshivimin e database

- pergatitjen e karteles daktiloskopike dhe dergimin e saj on-line ne databasen e sistemit AFIS/APIS Papillon 9 instaluar ne Sektorin e Daktiloskopise te Institutit te Policise Shkencore.

Ne keto terma nuk perfshihen:

vazhdimi i udhimit te ekspertit te shitesit ne vendin e operatorit te sistemit (ne rast nevojje ne pune e vendit te operatorit) vazhdimi i dergimit te paisjeve deri tek vendi i relaizimit te riparimit dhe kthimit. Per te riparuar hardwaret e treguara ne specifikimet ne aneksin 1 ne rast kur difektet e paisjeve jane shkaktuar si rezultat i difekteve te hardwareve te specifikimeve 1.1.

5. Te zevendesoje brenda 1 muaji pjese nga paisjet dhe softwaret e artikujve te aneksit 1 te specifikuara kur ato kane difekte, neqoftese aftesite e paisjeve nuk kane pesuar demtime mekanike.

Keto terma nuk perfshijne:

- kohen e dergimit te paisjeve deri ne vendin e riparimit e kthim.
- Ne kete kohe nuk perfshihen koha e riparimit te hardwareve te artikujve te aneksit 1 ne rast se sistemi ka pengesa te shkaktuar nga keto hardware.

Paisjet qe do te zevendesohen duhet te kene te njejtat karakteristika teknike ose edhe me te mira.

6. Te siguroje dergimin e paisjeve nga qyteti i Tiranes tek bleresi kur ato zevendesohen ose riparohen me shpenzimet e shitesit. Trasporti do te realizohet me ate tokesor.

7. Te ekzekutoje mbeshitetjen e paisjeve nepermjet linjes se hapur telefonike ne te gjitha ditet e punes nga ora 08 00 deri ora 16 30.

Perdoruesi ka per detyre:

1. te perdore paisjet sipas instruksioneve shpjeguese te guides te perdorimit te Live Skanerave tip DS-45.
2. te perdori sistemin e arshivimit ne database sipas te gjitha instruksioneve ne manualin e perdoruesit te Live Skanerave.
3. te perdori paisjet nga eksperte qe kane certifikaten e shitesit qe konfirmon kualifikimin e pershtatshem.

Specifikimet 1:1

Paisjet Live Skanera per marrjen e gjurmeve te duarve(gishta dhe pellembe) DS-45

Paisjet Live Skanera per kontrollin e gjurmeve te gishtave te tipit DS-45.

1. Paisjet Live Skanera per marrjen e gjurmeve te duarve te tipit DS-45 cope 26.
2. Softweri per kontrollin on-line me gjurme gishtash ne sistemin Afis, cope 26.
3. Softweri per pergatitjen e karteles daktiloskopike, cope 26
4. Monitor 21 “ 31KH-81KHz cope 26.
5. Printer Lazer Jet M402d cope 26.
6. Komjuter Min Ni Interp 3 cope 26.

-
7. Skaner i sheshte Canon 1000 cope 26.
 8. Aparat fotografik Canon 1200, cope 26.
 9. UPS 150VA, cope 26.

SPECIFIKIME TEKNIKE PER MIREMBAJTJEN TEKNIKE TE PAISJET E LIVE SKANERAVE PER MARRJEN E GJURMEVE TE DUARVE DPP-6P.

Kontraktuesi ka per detyre:

1. Te mbeshtese kapacitetin e paisjeve dhe softwareve te 15 cope Live Skanerave te tipit DPP-6P te instaluar ne PKK. Morine 1 cope, 1 cope ne PKK.Kapshtice, 1 cope ne DVKufirit dhe Migracionit Korce, ne PKK. Qafe Bote 1 cope, 2 cope ne PKK Kakavije, 1 cope ne DRKM Tirane, 1 cope PKK. Bllate, 1 cope PKK. Porti Vlores, 1 cope PKK.Porti Sarandes, 1 cope PKK.Muriqan, 1 cope PKK.Hani Hotit, 1 cope PKK 3 Urat, 1 cope DVKM. Kukes 1 cope, 1 cope PKK Qafe Thane.
2. Te ekzekutoje keshillimet e operatoreve te Live Skanerave (me anen e telefonit, fakseve, sherbimit postar, postes elektronike etj) duke perfshire materiale informacioni falas.
3. Te dergoje ndryshimet dhe plotesime ne instalimin e softwarit me anen e postes elektronike ose me CD-R pa pagesa shtese.
4. Te rivere ne gjendjen e meparshme brenda 10 diteve kalenderike te aftesive te paisjeve ne rast difektsh.

Me aftesi te paisjeve do te kuptohet aftesia e tyre per te ekzekutuar :

- futjen e informacionit te database,
- realizimin e kerkimeve ne database,
- rifreskimin e listes se kandidateve,
- arshivimin e database
- pergatitjen e karteles daktiloskopike dhe dergimin e saj on-line ne databasen e sistemit AFIS/APIS Papillon 9 instaluar ne Sektorin e Daktiloskopise te Institutit te Policise Shkencore.

Ne keto terma nuk perfshihen:

- vazhdimi i udhetimit te ekspertit te shitesit ne vendin e operatorit te sistemit (ne rast nevoje ne pune e vendit te operatorit)
 - vazhdimi i dergimit te paisjeve deri tek vendi i relaizimit te riparimit dhe kthimit.
 - Per te riparuar hardwaret e treguara ne specifikimet ne aneksin 1 ne rast kur difektet e paisjeve jane shkaktuar si rezultat i difekteve te hardwareve te specifikimeve 1.1
- 5.Te zevendesoje brenda 1 muaji pjese nga paisjet dhe softwaret e artikujve te aneksit 1 te specifikuar kur ato kane difekte, neqoftese aftesite e paisjeve nuk kane pesuar demtime mekanike.

Keto terma nuk perfshijne:

- kohen e dergimit te paisjeve deri ne vendin e riparimit e kthim.
- Ne kete kohe nuk perfshihen koha e riparimit te hardwareve te artikujve te aneksit 1 ne ras se sistemi ka pengesa te

shkaktuar nga keto hardware.

Paisjet qe do te zevendesohen duhet te kene te njejtat karakteristika teknike ose edhe me te mira.

6. Te siguroje dergimin e paisjeve nga qyteti i Tiranes tek bleresi kur ato zevendesohen ose riparohen me shpenzimet e shitesit. Transporti do te realizohet me ate tokesor.

7. Te ekzekutoje mbeshtetjen e paisjeve nepermjet linjes se hapur telefonike ne te gjitha ditet e punes nga ora 08 00 deri ora 16 30.

Perdoruesi ka per detyre:

1. te perdore paisjet sipas instruksioneve shpjeguese te guides te perdorimit te Live Skanerave tip DPP-6P.
2. te perdori sistemin e arshivimit ne database sipas te gjitha instruksioneve ne manualin e perdoruesit te Live Skanerave.
3. te perdori paisjet nga eksperte qe kane certifikaten e shitesit qe konfirmon kualifikimin e pershtatshem.

Specifikimet 1.1

Paisjet Live Skanera per marrjen e gjurmave te gishtave.

Live Skaner paisje tip Deep cope 15.
Softwarin perkates te Live Skanerave cope 15.
Softweri kontrollit operativ cope 15.

Loti i Dytë "Mirëmbajtje teknike e pajisjeve Biofad".

SPECIFIKIME TEKNIKE PER MIREMBAJTJEN TEKNIKE TE PAISJET E LIVE SKANERAVE TIP BIOFAD

Kontraktuesi ka per detyre :

1. Te mbeshtese kapacitetin e paisjeve dhe softwareve te 5 cope Live Skanerave te tipit Biofad te instaluar ne Komisariatit e Kufirit te Portit Shengjin.
2. Te siguroje mbeshtetje teknike per paisjet hardweret speciale celular Samsung A33 5G dhe softwareve Efad-Biofad dhe ate te njohjes se fytyres humane.
3. Te mbeshtesi bleresin me softwerin e updeituar per periudhen e mbeshtetjes.
4. Te ekzekutoje keshillat e operatoreve te sistemit me anen e linjes telefonike, faks, sherbim postar, poste elektronikeetj, si dhe me material informues falas.
5. Te shperndaje ndryshime dhe shtesa me anen e postes elektronike te softëerit ose me anen e CD pa asnje pagese shtese.
6. Te rivendose operativitetin e paisjeve brenda 3 diteve kalendarike nga dita e njoftimit me shkrim rreth difektit. Operativiteti i paisjes kupton mundesine e saj per te ekzektuar futjen e informacionit ne databaze dhe realizimin e kerkimeve ne databaze.

-
7. Te kontrolloje dhe riparoje te gjitha gabimet ne sistemin e skedareve per kerkimin automatik, kalibrimin, indeksimin ne paisjet Biofad.
 8. Te zevendesojte pasijet speciale te specifikuara ne listen e paisjeve speciale dhe softëereve Biofad, brenda 1 muaji ne qofte se operativiteti i ketyre paisjve nuk eshte dhunuar. Ky term nuk perfshin kohën e dergimit dhe te kthimit mbrapsh te ketyre paisjeve ne vendin perkates derisa ato te riparohen. Paisjet e percaktuar ne listen e paisjeve speciale dhe softëereve Biofad duhet te zevendesohen me paisje qe kane te njejtat karakteristika teknike si ato origjinale ose te dhena teknike me te mira.

Perdoruesi duhet:

1. Te perdori paisjet dhe softweret sipas instruksioneve te prodhuesit dhe manualit te perdorimit te paisjes Biofad.
2. Te perdori paisjen Biofad nga specialiste qe jane certifikuar nga shitesi qe provojne kualifikimin e nevojshem.

Paisjet Biofad jane të lidhura on-line me dy sistemet ate AFAIS (Sistemin e identifikimit automatik të fytyrës, AFAIS (Automated Face Analyze Identification Systems), si dhe me sistemin AFIS (Sistemi automatik i identifikimit te gjurmëve te gishtave), nëpërmjet rrjetit te IT te Policise Shtetit, fale instalimit te softwerit te komunikimit dhe do të analizojnë të dhënat dhe elementët e sigurisë në dokumentet e identifikimit, pasaporta, viza të ndryshme hyrëse, dokumente udhëtimi etj.

Këto paisje Biofad do te duhet analizojne elemente sigurie qe i kanë databazën e tyre duke përdorur sensore dixhitale për leximin e tyre nga cipi RFID, duke identifikuar personin me të dhënat biometrike të fytyrës të ruajtur në cip, leximin e kodit ICAO (MRZ) si dhe leximin e elementëve të sigurisë të këtyre dokumenteve duke përdorur të dhënat e specimenëve të tyre të ruajtura në kartën grafike të memories të pajisjes, e cila duhet te kete një kapacitet ruajtje të informacionit deri 1 Terabite.

Këto pajisje Biofad kane ne perdorim nje celular Android Samsung A 33 i cili bën të mundur këqyrjen e dokumenteve nëpërmjet nje aplikacioni dhe lidhjen me databazës për të krahasuar këto dokumente me specimenet e ruajtura aty.

Informacioni ne kartën e memories është për të gjitha elementet e sigurise te dokumenteve te udhetimit te 140 vendeve të botës. Paisjet portable do te duhet te kryejne analizën biometrike të informacionit të ruajtur në kodin ICAP(MRZ), të gjurmëve të gishtave të personit me imazhin e gjurmëve të gishtave të ruajtura në cipin e dokumentit si dhe të imazhit të fytyrës 1 me 1 me të personit që është posedues i pasaportën.

Po keshtu, ato bejne dhe kerkimin e krahasimit te imazhit të fytyrës në databazën e sistemit AFAIS dhe nëse ka përputhshmëri. Ky informacion do te duhet te shfaqet ne % se sa përputhshmëri ka midis objektit qe ekzamonohet me modelin ne databazen qendrore dhe nuk ka nevojë për ekspert që të përcaktojë identitetin sepse aparatura dhe softi është aq i përparuar saqë përcakton vetëm një kandidat të përputhur.

Po kështu, ato do bëjnë edhe kontrollin e identitetit të personit me anën e gjurmëve të gishtave në kohë reale në databazën e të dhënave të sistemi AFIS Papillon 9. Rezultatet e kërkimeve marrën përsëri në terminal ku përfshihen të gjitha informacionet e hollësishme të lidhura me individin që gjendet në bazat e të dhënave të kartelave daktiloskopike dhe galeritë e portreteve të fytyrës. Kështu, për shembull, kur një oficer fillon kontrollimin e një individi për identifikimin me gjurmë gishtash ai merr përsëri në terminalin portabel të gjitha informacionet nga të gjitha regjistrimet e krijuara ndonjëherë për këtë individ (emri, vendi marrjes së gjurmëve të gishtave, data e marrjes të gjurmëve të gishtave dhe Komisarariatit i Policisë ku janë marrë gjurmet papilare, numrin e regjistrimit kriminal).

Nr.	Përshkrimi	Brand	Model	Sasia
1	BIOFAD	SECOM	FP30	5
2	SMARTPHONE	SAMSUNG	A33 5G	5
3	SOFTWARE Efad- Biofad	SECOM		5
4	SOFTWARE PER NJOHJEN E FYTYRES	SECOM		5

Nr	STRUKTURA KU JANE INSTALUAR	Pajisjet Biofad cope
1	Komisariati i Policisë të Kufitar Porti Shengjin (PKK Shengjin)	5
	TOTALI	5 cope

Shënim *

Çdo markë, tip, model, prodhues ose teknologji e specifikuar shoqërohet me termin “ose ekuivalente”.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: "Mirëmbajtje teknike e 50 copë aparaturave live skanera të tipeve DS-40, DS-45, DPP-6P dhe Biofad", të ndarë sipas Loteve:

Loti i Parë "Mirëmbajtje teknike të aparaturave live skanera të tipeve DS-40, DS-45, DPP-6P".

Loti i Dytë "Mirëmbajtje teknike e pajisjeve Biofad".

Afatet e ekzekutimit:

Nr	Emërtimi i shërbimit	Afati i ekzekutimit
1	Loti i Parë "Mirëmbajtje teknike të aparaturave live skanera të tipeve DS-40, DS-45, DPP-6P".	3 vite nga nënshkrimi i kontratës
2	Loti i Dytë "Mirëmbajtje teknike e pajisjeve Biofad".	3 vite nga nënshkrimi i kontratës

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Sipas Specifikimeve Teknike

Detyrat: Sipas Specifikimeve Teknike

Shpërndarja: Sipas Specifikimeve Teknike

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Sipas Specifikimeve Teknike

Loti i Parë "Mirëmbajtje teknike të aparaturave live skanera të tipeve DS-40, DS-45, DPP-6P".

Instituti i Policisë Shkencore kërkon të realizojë shërbimin për mirëmbajtje teknike 3 vjeçare të pajisjeve live skanera. Me realizimin e këtij shërbimi synohet sigurimi dhe realizimi i praktikave si më poshtë:

- Identifikimi i shpejtë i të gjithë të ndaluarve/arrestuarve, personave të depërtuar, emigrantët e paligjshme me anën e gjurmëve të gishtave të sistemin Afis/Apis dhe me anën e fytyrës në sistemin AFAIS.
- Krahasimi automatik në sistemin Afis/Apis të gjurmëve të duarve të personave të ndaluar/arrestuar, personave deportiv me qëllim identifikimin e shpejtë të gjurmëve të duarve që janë administruar si prova shkencore në çështjet penale në hetim apo të pezulluara.
- Identifikimin e menjëhershëm me gjurmët e gishtave dhe fytyrës të të gjithë personave që janë shpallur në kërkim dhe kërkojnë të kalojnë në Pikat e Kalimit Kontrollit me anën e paisjeve Live skanera.
- Dërgimi on-line në kohë reale direkt në sistemin Afis/Apis të imazheve të gjurmëve të duarve që do të zbulohen dhe administrohen si prova shkencore në vendet e

ngjarjeve (kryesisht për ngjarjet e rënda) me qëllim identifikimin e autorit me anën e gjurmëve të gishtave në databazën e këtij sistemi brenda ditës.

- Krijimin e mundësisë për të kaluar në krahasimin automatik të të dhënave daktiloskopike midis sistemit tonë Afis/Apis dhe sistemeve të 10 vendet anëtare të Konventës së Bashkëpunimit Policor të Vendeve të Evropës Juglindore (PCC SEE) si Austria, Hungaria, Sllovenia, Bullgaria, Rumania, Serbia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Bosnje Hercegovina dhe Moldavia.

Për të realizuar mirëmbajtje teknike 3 vjecare të live skanerave për marrjen e gjurmëve të gishtave, operatori ekonomik duhet :

1. Te mbeshtese kapacitetin e paisjeve dhe softwareve te 45 cope Live Skanerave te tipit DPP-6P, DS-40, DS-45.

2. Te ekzekutoje keshillimet e operatoreve te Live Skanerave (me anen e telefonit, fakseve, postes elektronike etj) duke perfshire materiale informacioni falas.

3. Te dergoje ndryshimet dhe plotesime ne instalimin e softwarit me anen e postes elektronike ose me CD-R pa pagesa shtese.

4. Te rivere ne gjendjen e meparshme brenda 10 diteve kalenderike te aftesive te paisjeve ne rast difektesh.

Me aftesi te paisjeve do te kuptohet aftesia e tyre per te ekzekutuar :

- futjen e informacionit ne database e sitemit AFIS;
- realizimin e kerkimeve ne database e sistemit AFIS;
- rifreskimin e listes se kandidateve;
- arshivimin ne databazen e sistemit AFIS;
- pergatitjen e karteles daktiloskopike dhe dergimin e saj on-line ne databasen e sistemit

AFIS/APIS Papillon 9 instaluar ne Sektorin e Daktiloskopise te Institutit te Policise Shkencore.

Ne keto terma nuk perfshihen:

- vazhdimi i udhetimit te ekspertit te shitesit ne vendin e operatorit te sistemit;
- vazhdimi i dergimit te paisjeve deri tek vendi i relaizimit te riparimit dhe kthimit;
- Per te riparuar hardwaret e treguara ne specifikimet ne aneksin 1 ne rast kur difektet e paisjeve jane shkaktuar si rezultat i difekteve te hardwareve te specifikimeve 1.1

5. Te zevendesoje brenda 1(nje) muaji pjese nga paisjet dhe softwaret e artikujve te aneksit 1 te specifikuara kur ato kane difekte, neqoftese aftesite e paisjeve nuk kane pesuar demtime mekanike.

Keto terma nuk perfshijne:

- kohen e dergimit te paisjeve deri ne vendin e riparimit e kthim.
- Ne kete kohe nuk perfshihen koha e riparimit te hardwareve

te artikujve te aneksit 1 ne ras se sistemi ka pengesa te shkaktuar nga keto hardware.

Paisjet qe do te zevendesohen duhet te kene te njejtat karakteristika teknike ose edhe me te mira.

6. Te siguroje dergimin e paisjeve nga qyteti i Tiranes tek bleresi kur ato zevendesohen ose riparohen me shpenzimet e shitesit. Transporti do te realizohet me ate tokesor.

7. Te ekzekutoje mbeshtetjen e paisjeve nepermjet linjes se hapur telefonike ne te gjitha ditet e punes nga ora 08 00 deri ora 16 30.

Bleresi duhet:

1. Te perdore paisjet sipas instruksioneve shpjeguese te guides te perdorimit te Live Skanerave sipas tipeve.

2. Te perdori sistemin e arshivimit ne database sipas te gjitha instruksioneve ne manualin e perdoruesit te Live Skanerave.

3. Te perdori paisjet nga eksperte qe kane certifikaten e shitesit qe konfirmon kualifikimin e pershtatshem.

Lista e paisjeve speciale(harwere) dhe softveve(software) të paisjeve live skanera që përfshihen në mbështetjen teknike është si më poshtë :

Specifikimet 1:1

Nr.	Paisjet speciale dhe softweret	Njesia	Sasia
1	Paisjet live skaner model DPP-6P	cope	15
2	Softwarin per pergatitjen e karteles daktiloskopike me Live Skaner model DPP-6P	cope	15
3	Softweri i kontrollit me gjurme gishtash ne sistemin AFIS nga paisja live skanerave DPP-6P	cope	15
4	Paisjet Live Skanera per marrjen e gjurmeve te duarve te tipit DS-40	cope	4
5	Softweri per pergatitjen e karteles daktiloskopike nga paisja live skanerit DS-40	cope	4
6	Softweri i kontrollit me gjurme gishtash ne sistemin AFIS nga paisja live skanerave DS-40.	cope	4
7	Komjuter Pentium 4 IBM Intellistation E PRO CPU Pentium 4 2,2 Ghz, 256 RAM, HDD 40 GB	cope	4
8	Monitor 17 “ IBM T 39U3EU FD Trinitron 0,24, TCO-95	cope	4
9	Printer Lazer Jet 1200	cope	4
10	UPS 150VA per live skanerat DS-40 dhe DS-45	cope	30
11	Paisjet Live Skanera per marrjen e gjurmeve te duarve te tipit DS-45	cope	26
12	Softweri per kontrollin me gjurme gishtash ne istemin AFIS nga live skanerit DS-45	cope	26
13	Softweri i kontrollit me gjurme gishtash ne sistemin AFIS nga paisja live skanerave model DS-45	cope	26
14	Monitor 21 “ 31KH-81KHz per live skaner DS-45	cope	26

15	Printer Lazer Jet M402d per live skaner DS-45	cope	26
16	Komjuter Min Ni Interp 3 per live skaner DS-45	cope	26
17	Skaner i sheshte Canon 1000 per live skaner DS-45	cope	26
18	Aparat fotografik Canon 1200 per live skaner DS-40 dhe DS-45	cope	30

Shënim *

Çdo markë, tip, model, prodhues ose teknologji e specifikuar shoqërohet me termin “ose ekuivalente”.

Terma Reference për Loti i Dytë "Mirëmbajtje teknike e pajisjeve Biofad".

Instituti i Policisë Shkencore kërkon të realizojë shërbimin për mirëmbajtje teknike 3 vjeçare të pajisjeve live skanera. Me realizimin e këtij shërbimi synohet sigurimi dhe realizimi i praktikave si më poshtë:

- Identifikimi i shpejtë i të gjithë të ndaluarve/arrestuarve, personave të depërtuar, emigrantët e paligjshme me anën e gjurmëve të gishtave të sistemin Afis/Apis dhe me anën e fytyrës në sistemin AFAIS nga pajisjet Biofad.
- Krahasimi automatik në sistemin Afis/Apis të gjurmëve të duarve të personave të ndaluar/arrestuar, personave deportiv me qëllim identifikimin e shpejtë të gjurmëve të duarve që janë administruar si prova shkencore në çështjet penale në hetim apo të pezulluara.
- Identifikimin e menjëhershëm me gjurmët e gishtave dhe fytyrës të të gjithë personave që janë shpallur në kërkim dhe kërkojnë të kalojnë në Pikat e Kalimit Kontrollit me anën e paisjeve Live skanera Biofad.
- Dërgimi on-line në kohë reale direkt në sistemin Afis/Apis të imazheve të gjurmëve të duarve që do të zbulohen dhe administrohen si prova shkencore në vendet e ngjarjeve (kryesisht për ngjarjet e rënda) me qëllim identifikimin e autorit me anën e gjurmëve të gishtave në databazën e këtij sistemi brenda ditës.
- Krijimin e mundësisë për të kaluar në krahasimin automatik të të dhënave daktiloskopike midis sistemit tonë Afis/Apis dhe sistemeve të 10 vendet anëtare të Konventës së Bashkëpunimit Policor të Vendeve të Evropës Juglindore(PCC SEE) si Austria, Hungaria, Sllovenia, Bullgaria, Rumania, Serbia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Bosnje Hercegovina dhe Moldavia.

Për të realizuar mirëmbajtje teknike 3 vjeçare paisjeve për marrjen e gjurmëve të gishtave, operatori ekonomik duhet :

1. Te mbeshtese kapacitetin e paisjeve dhe softwareve te Live Skanerave te tipit Biofad.
2. Te ekzekutoje keshillimet e operatoreve te Live Skanerave (me anen e telefonit, fakseve, postes elektronike etj) duke perfshire materiale informacioni falas.
3. Te dergoje ndryshimet dhe plotesime ne instalimin e softwarit me anen e postes elektronike ose me CD-R pa pagesa shtese.

4. Te rivere ne gjendjen e meparshme brenda 10 diteve kalenderike te aftesive te paisjeve ne

rast difektesh.

Me aftesi te paisjeve do te kuptohet aftesia e tyre per te ekzekutuar :

- futjen e informacionit ne database e sitemit AFIS;
- realizimin e kerkimeve ne database e sistemit AFIS;
- rifreskimin e listes se kandidateve:
- arshivimin ne databazen e sistemit AFIS;
- pergatitjen e karteles daktiloskopike dhe dergimin e saj on-line ne databasen e sistemit

AFIS/APIS Papillon 9 instaluar ne Sektorin e Daktiloskopise te Institutit te Policise Shkencore.

Ne keto terma nuk perfshihen:

- i. vazhdimi i udhetimit te ekspertit te shitesit ne vendin e operatorit te sistemit;
- ii. vazhdimi i dergimit te paisjeve deri tek vendi i relaizimit te riparimit dhe kthimit;
- iii. Per te riparuar hardwaret e treguara ne specifikimet ne aneksin 1 ne rast kur difektet e paisjeve jane shkaktuar si rezultat i difekteve te hardwareve te specifikimeve 1.1

5. Te zevendesoje brenda 1(nje) muaji pjese nga paisjet dhe softwaret e artikujve te aneksit 1 te specifikuara kur ato kane difekte, neqoftese aftesite e paisjeve nuk kane pesuar demtime mekanike.

Keto terma nuk perfshijne:

- kohen e dergimit te paisjeve deri ne vendin e riparimit e kthim.
- Ne kete kohe nuk perfshihen koha e riparimit te hardwareve te artikujve te aneksit 1 ne ras se sistemi ka pengesa te shkaktuar nga keto hardware.

Paisjet qe do te zevendesohen duhet te kene te njejtat karakteristika teknike ose edhe me te mira.

6. Te siguroje dergimin e paisjeve nga qyteti i Tiranes tek bleresi kur ato zevendesohen ose riparohen me shpenzimet e shitesit. Transporti do te realizohet me ate tokesor.

7. Te ekzekutoje mbeshtetjen e paisjeve nepermjet linjes se hapur telefonike ne te gjitha ditet e punes nga ora 08 00 deri ora 16 30.

Bleresi duhet:

1. Te perdore paisjet sipas instruksioneve shpjeguese te guides te perdorimit te Live Skanerave sipas tipeve.
2. Te perdori sistemin e arshivimit ne database sipas te gjitha instruksioneve ne manualin e perdoruesit te Live Skanerave.

3. Te perdori paisjet nga eksperte qe kane certifikaten e shitesit qe konfirmon kualifikimin e pershtatshem.

Lista e paisjeve speciale(harwere) dhe softeve(softwere) te paisjeve live skanera qe përfshihen në mbështetjen teknike është si më poshtë :

Specifikimet 1:1

Nr.	Paisjet speciale dhe softweret	Njesia	Sasia
1	Paisjet multifunkionale biometrike Biofad model FP30	cope	5
2	Softweri Efad Biofad i kërkimit ne sistemin AFIS te gjurmëve te gishtave nga paisja Biofad.	cope	5
3	Softweri i kërkimit ne sistemin AFAIS te face recognition nga paisja Biofad.	cope	5
4	Telefon celular smart SAMSUNG A33 5G i lidhur me paisjen Biofad.	cope	5

Shënim *

Çdo markë, tip, model, prodhues ose teknologji e specifikuar shoqërohet me termin “ose ekuivalente”.

Shtojca 9 Loti i Parë "Mirëmbajtje teknike të aparaturave live skanera të tipeve DS-40, DS-45, DPP-6P".

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

1.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Përsa më sipër, nëse ofertuesi aplikon për të gjitha lotet, rrjedhimisht duhet të kujdeset që vlera për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës, të arrijë të plotësojë vlerën e kërkuar për aq lote sa aplikon (të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar), në mënyrë që të arrijë të provojë kapacitetin e tij financiar-ekonomik për mundësinë e realizimit me sukses të të gjitha loteve ku aplikon.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2023, 2024, 2025), të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Përsa më sipër, nëse ofertuesi aplikon për të gjitha lotet, rrjedhimisht duhet të kujdeset që vlera për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, të arrijë të plotësojë vlerën e kërkuar për aq lote sa aplikon, në mënyrë që të arrijë të provojë kapacitetin e tij teknik për mundësinë e realizimit me sukses të të gjitha loteve ku aplikon.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se është i pajisur me çertifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë:

S SH EN ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;
S SH ISO/IEC 27001 mbi – “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”, “ Siguria e informacionit, siguria kibernetike dhe mbrojtja e privatësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

S SH ISO/IEC 20000-1 “Menaxhimi i shërbimit TI”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

Çertifikatat duhet të jenë e lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë që ka të paktën 8 (tetë) punonjës të siguar për muajin e fundit nga momenti i hapjes së ofertave, ku të përfshihen jo më pak se 3 (tre) Inxhinierë/Specialistë të siguar, të diplomuar në degët e Inxhinierisë Elektronike / Inxhinieri Informatike / Teknologji Informacioni / Informatikë / Informatikë Matematikë / Inxhinieri Matematike dhe Informatikë / Informatikë Ekonomike / Inxhinieri Telekomunikacioni që do të angazhohen në zbatimin e kontratës. Për keta punonjës të paraqitet diploma e kërkuar dhe kontrata e punës e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues.

